



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice  
Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Office of the Minister of Justice

Prishtinë, 25.08.2023

**UDHËZIM PËR ODËN E PËRMBARUESVE PRIVAT TË KOSOVËS**

Ministria e Drejtësisë, bazuar në platformën e lansuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) lidhur me subvencionimin e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore për nxënësit për vitin shkollor 2023/2024, lëshon udhëzimin si në vijim:

1. Udhëzohen zyrat e përmbaruesve privat që në pajtim me situatën faktike, të shqyrtojnë mundësitë për lehtësimin e pagesave nga llogaritë e bllokuara të debitorëve - prindër të nxënësve përfitues nga platforma e lansuar nga MASHTI për subvencionin e teksteve shkollore (përmes zhblokimit të përkohshëm të llogarive të bllokuara të debitorëve në rastet kur të njëjtit pranojnë mjete financiare subvencionuese të destinuar për blerjen e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore me qëllim të tërheqjes së këtyre mjeteve deri në vlerën e destinuar për këtë qëllim).
2. Ky Udhëzim në asnjë rrethanë nuk synon ta cenojë pavarësinë ligjore dhe profesionale të përmbaruesve privat, por ka për qëllim të udhëzojë për veprime të duhura në situatën aktuale sa i përket pajisjes së nxënësve me tekste dhe materiale të tjera mësimore.

**Albulona HAXHIU**  
  
**Ministria e Drejtësisë**